



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 34

Tiranë – E hënë, 19 tetor 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Njoftim i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronës Publike të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 18921, datë 12.10.2020	Për shitje me ankand të pronës shtetërore, në administrim të Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë, Tiranë, si dhe të shoqërisë “Kamberi” dhe të shoqërisë “Gjallica”..... 3
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 3948, datë 2.10.2020	Për ndërprerjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Luval” sh.p.k..... 4
Kërkesë e Ministrisë së Drejtësisë nr. 6547, datë 19.10.2020	Për shprehje interesi të kandidatëve të interesuar për t’u zgjedhur anëtarë të Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë, si dhe anëtar i Komisionit Disiplinor të Përmbauesve Gjyqësorë Privatë..... 15

**NJOFTIM**

Nr. 18921, datë 12.10.2020

**PËR SHITJE ME ANKAND TË
PRONËS SHTETËRORE, NË
ADMINISTRIM TË INSTITUTIT TË
PËRGATITJES SË QENVE TË POLICISË,
TIRANË**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret

e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, shpall për shitje me VAM fillestar, si më poshtë:

1. Në administrim të Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë, Tiranë

Nr.	Emërtimi	Datëlindja	Vendndodhja	Vlera fillestare e ankandit në lek	Zhvillimi i ankandit		
					Data	Ora	Vendi
1	Qeni Lisi	22.6.2019	Tiranë	20 000	11.11.2020	09:00	DDPP
2	Qeni Uga	22.6.2019	Tiranë	20 000	11.11.2020	09:30	DDPP
3	Qeni Asta	22.6.2019	Tiranë	20 000	11.11.2020	10:00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik, i interesuar për blerje, duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerje e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.

2. **Garancinë bankare apo mandatpagesën** në original, që vërteton ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lek, për llogari të Ministrisë së Financave.

3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e shpallur për shitje, i konfiskohet 20% e garancisë bankare, e ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Garancia bankare apo mandatpagesa duhet të bëhet detyruesisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Garancia bankare apo mandatpagesa mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive

të hapura për Ministrinë e Financave, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë: www.financa.gov.al.

NJOFTIM

Nr. 18921, datë 12.10.2020

**PËR SHITJE ME ANKAND TË
PRONËS SHTETËRORE, NË
ADMINISTRIM
TË SHOQËRISË “KAMBERI”, SI DHE
TË SHOQËRISË “GJALLICA”**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, shpall për shitje me VAM fillestar si më poshtë:

1. Në pronësi të shoqërisë “Kamberi” sh.p.k.

Nr.	Emërtimi	Vendndodhja	Vlera fillestare e ankandit në lekë	Zhvillimi i ankandit		
				Data	Ora	Vendi
1	Linja e prodhimit të sallamit	Vlorë	258 400	11.11.2020	11:30	DDPP
2	Motor-gjenerator	Tiranë	110 000	11.11.2020	10:30	DDPP



2. Në pronësi të shoqërisë “Gjallica” sh.p.k.

Nr.	Emërtimi	Vendndodhja	Vlera fillestare e ankandit në lekë	Zhvillimi i ankandit		
				Data	Ora	Vendi
1	Automjet Mercedes-Benz	Tiranë	58 500	11.11.2020	11:00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik, i interesuar për blerje, duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerje e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.

2. **Garancinë bankare apo mandatpagesën** në original, që vërteton ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë, për llogari të Ministrisë së Financave.

3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e shpallur për shitje, i konfiskohet 20% e garancisë bankare, e ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Garancia bankare apo mandatpagesa duhet të bëhet detyrimsht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Garancia bankare apo mandatpagesa mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave, pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe, faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë: www.financa.gov.al.

VENDIM

Nr. 3948, datë 2.10.2020

PËR NDËRPRERJEN E PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përberë nga:

Julian Haxhiu, gjyqtar,

Sot, më datë 2.10.2020, asistuar nga sekretare gjyqësore Klaudia Abazaj, mori në shqyrtim kërkesën civile tregtare të administratorit, si më poshtë:

KËRKUES: Luan Muça, administrator i falimentimit të shoqërisë “Luval” sh.p.k.

OBJEKTI: Për hapjen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Luval” sh.p.k.

BAZA LIGJORE: Nenet 126, 306–308 të Kodit të Procedurës Civile, nenet 3, 4, 5, 6, 172, 174 e në vijim, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar).

Gjykata, në përfundim të shqyrtimit të kërkesës, si më lart:

VËREN:

Shoqëria “Luval” sh.p.k., në falimentim është një shoqëri tregtare e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 24499, datë 18.12.2000. Kjo shoqëri ushtronte aktivitetin tregtar në fushën e prodhimit dhe të tregtimit të tullave, tjegullave, import-eksport etj.

Me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 12508, datë 18.12.2012, është:

- Pranimin e kërkesës së kërkuarit shoqëria “Luval” sh.p.k.

- Hapjen e procedurës së falimentimit të shoqërisë, shoqëria “Luval” sh.p.k., me seli në fshatin Vasjar, Tepelenë.

- Emërimin si administrator të falimentimit për shoqërinë “Luval” sh.p., z. Luan Muça.

Procedura e falimentimit të kësaj shoqërie është zgjatur prej shumë vitesh për arsye të ndryshme objektive. Gjykata ka kryer të gjitha përpjekjet ligjore që kjo procedurë të shkojë drejt përfundimit në një kohë sa më të arsyeshme, duke ftuar administratorin që të studiojë dhe të paraqesë planin e tij për shitjen e masës së falimentimit ose për riorganizimin ekonomik të kësaj shoqërie. Duke qenë se kjo shoqëri ndodhet prej shumë vitesh në këtë procedurë falimentimi, administratori i falimentimit i është drejtuar Gjykatës për të caktuar me vendim ndërprerjen e procedurës së falimentimit, pasi janë plotësuar kushtet e neneve 172, 174 e në vijim, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar).



Në momentin e shqyrtimit të kërkesës, objekt gjykimi, Gjykata vëren se janë mbajtur mbledhja për raportim dhe mbledhja për verifikimin e pretendimeve, të cilat kanë përfunduar me miratimin e tabelave përkatëse të pretendimeve të kreditorëve të shoqërisë “Luval” sh.p.k.

Në përshkrim të historikut të kësaj procedure

Inventarin e marrë në dorëzim me vlerë kontabël e paraqesim në tabelën si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Sipërfaqja ndërtimore m ²	Vlera kontabël
I	Ndërtesa		50,970,680
1	Kapanoni i dheut (konstruksioni është kolonë beton armeje mbuluar me kapriata metalike)	825	1,237,500
2	Kolergani (konstruksioni i godinës është me kolona betoni armeje mbuluar me kapriata metalike)	150	180,000
3	Ofiçina (konstruksioni është me mur tulle dhe i mbuluar me kapriata metalike)	132	216,480
4	Kabina elektrike (konstruksioni i godinës është me mur tulle dhe soletë me beton armeje)	218	479,600
5	Salla e makinerive (konstruksioni i godinës është me kolona beton armeje, me mur tulle dhe mbulesa me kapriata metalike)	1000	1,640,000
6	Tunelet e tharjes (konstruksion mur tulle dhe e mbuluar me soletë beton armeje. DysHEMEJA me shtresë betoni dhe linja dekovili)	1781	4,630,600
7	Furra tunel (konstruksion beton armeje mbuluar me kapriata metalike, muret anësore me tullë të zakonshme, veshjet e brendshme me tullë reflaktare, dysHEMEJA me beton dhe linja dekovili)	1500	33,000,000
8	Furra <i>ofmaan</i> (Konstruksion beton armeje mbuluar me kapriata metalike, muret anësore me tullë të zakonshme, qemerët me tulla të zakonshme dhe kanali kryesor i gazrave me tulla të zakonshme)	913	9,586,500
II	Makineritë		
1	Torno	~	~
2	Trapan me korrent	~	~
3	Pompa uji	~	~
4	Share prerje hekuri	~	~
5	Mulliri bluarjes së baltës	~	~
6	Transportieri mbi mullirin e bluarjes	~	~
7	Transportieri që shkon te presa	~	~
8	Brumatriçja	~	~
9	Cisterna e ujit	~	~
10	Shtytësi në sallën e prerjes së tullave	~	~
11	Ventilatori i ajrimit	~	~
12	Transportieri jashtë që shkon në furrën e pjekjes	~	~
13	Sondë shpimi që bën minat	~	~
14	Traktor i verdhë me zinxhir	~	~
15	Shtrate vagonane tunel dhe 25 vagonë në korridor	~	~



Nga raportimet e administratorit, për ruajtjen e objektit është organizuar shërbimi 24-orësh, në tri turne, me nga një punonjës për çdo turn. Për periudhën 18.12.2012 deri në datën 8.7.2014 nuk janë zhvilluar mbledhje të kreditorëve, pasi, sipas gjykatës, dosja ka shkuar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Mbledhja e parë e kreditorëve të shoqërisë “Luval” sh.p.k., Tepelenë është zhvilluar në datën 8.7.2014.

Në mbledhjen e radhës së kreditorëve të falimentimit, datë 22.7.2014, administratori i shoqërisë “Luval” sh.p.k., Tepelenë ka paraqitur dokumentacionin, si më poshtë:

1. Raport mbi situatën ekonomiko-financiare të shoqërisë “Luval” sh.p.k., Tepelenë.

2. Raport mbi kreditorët e shoqërisë “Luval” sh.p.k., Tepelenë.

3. Aneksi 1 “Inventari i aktiveve të biznesit”.

4. Aneksi 2 “Lista e pretendimeve të kreditorëve”.

5. Aneksi 3 “Tabela përfundimtare e kreditorëve të falimentimit” (VO i korrigjuar në mbledhjen e kreditorëve, datë 15.1.2015).

6. Aneksi 4 “Lista e debitorëve”.

7. Aneksi 5 “Bilanci fillestar i falimentimit”.

Dokumentet si më sipër janë aprovuar në mbledhjen e kreditorëve, datë 25.2.2015.

Tabela përfundimtare e kreditorëve të falimentimit e përgatitur nga administratori është në tabelën si më poshtë:

Nr.	Kreditori	Pretendime të vërtetuara		
		%	Lek	Shënime
1	Ferdinant Alimema	1.33		1.33% e çmimit të shitjes së fabrikës
2	Leonora Luzi	1.33		1.33% e çmimit të shitjes së fabrikës
3	Ervehe Malka	1.33		1.33% e çmimit të shitjes së fabrikës
4	Shkëmbore Shehu	1.33		1.33% e çmimit të shitjes së fabrikës
5	Roland Xhelita	1.33		1.33% e çmimit të shitjes së fabrikës
6	Fatmir Lici	1.33		1.33% e çmimit të shitjes së fabrikës
7	Evgjeni Mane	1.33		1.33% e çmimit të shitjes së fabrikës
8	Mjaftoni Alinanaj	1.33		1.33% e çmimit të shitjes së fabrikës
9	Flutura Kaja	1.33		1.33% e çmimit të shitjes së fabrikës
10	Donika Harizi	1.33		1.33% e çmimit të shitjes së fabrikës
11	Gëzim Caushi	1.33		1.33% e çmimit të shitjes së fabrikës
12	Xhaferr Kanushi	1.33		1.33% e çmimit të shitjes së fabrikës
13	Fluturim Alinanaj	1.33		1.33% e çmimit të shitjes së fabrikës
14	Muco Harizi	1.33		1.33% e çmimit të shitjes së fabrikës
15	Hekuran Saliu	1.33		1.33% e çmimit të shitjes së fabrikës
16	Tatjana Zhupa	1.33		1.33% e çmimit të shitjes së fabrikës
17	Rozeta Lici	1.33		1.33% e çmimit të shitjes së fabrikës
X	Shuma 1-17	22.67		
18	Krenar Sula		626,250	
19	Krenar Sula		650,097	
20	Krenar Sula		3,707,727	



21	Krenar Sula		7500000	
X	Shuma 18-21	32.78	12,484,074	
22	Veiz Sinomema		459,250	
23	Veiz Sinomema		442,791	
24	Veiz Sinomema		2,492,694	
X	Shuma 22-24	8.91	3,394,735	
25	Kreshnik Sinomema		459,250	
26	Kreshnik Sinomema		442,791	
27	Kreshnik Sinomema		2,492,694	
X	Shuma 25-27	8.91	3,394,735	
28	Qemal Resuli	0.45	170,000	
29	Albert Musteqa	0.01	5,000	
30	Alem Shehu	26.26	10,000,000	
x	Shuma 18–30	77.33	29,448,544	

Mbledhja e kreditorëve, datë 18.12.2017, i kërkoi administratorit të falimentimit mundësinë e një plani për riorganizimi të shoqërisë.

Administratori i falimentimit i paraqiti mbledhjes së kreditorëve të datës 24.1.2018, raportin për mundësinë e riorganizimit të shoqërisë. Në raport administratori theksoi se në kushtet aktuale të gjendjes së shoqërisë, është i pamundur riorganizimi i shoqërisë.

Mbledhja e kreditorëve, datë 26.2.2018, ka miratuar raportin e administratorit për pamundësinë e riorganizimit të shoqërisë.

Administratori i falimentimit ka organizuar ankande për shitjen e objektit si njësi më vete si më poshtë:

1. Në datën 11 qershor 2018, ora 12:00 është zhvilluar ankandi për një vlerë prej 25,600,000 lekë (80% e vlerës fillestare.) Mirëpo ankandi dështoi.

Mbledhja e kreditorëve vendosi që ankandi të përsëritet me të njëjtën vlerë në datat 12.7.2018, si dhe në datën 11.9.2018.

Përfundimisht, ankandet e zhvilluara me një vlerë fillestare prej 25,600,000 lekësh dështuan. Ndodhur në këto kushte, mbledhja e kreditorëve, datë 11.9.2018 autorizoi administratorin që të përgatisë dokumentacionin për ankand të ri me vlerë të re.

2. Në datën 15.11.2018, ora 11:00, u zhvillua ankandi me një vlerë të re 9.000.000 lekë. Edhe ky ankand dështoi për mospasje të kërkesave.

Ankandi u përsërit në datat 20.12.2018, datë 2.4.2019, datë 20.5.2019, por në të gjitha rastet dështoi për mungesë ofertash. Në këto kushte mbledhja e kreditorëve autorizoi administratorin që të përgatiste dokumentet për ankand të ri dhe me vlerë të re.

3. Në datën 15.7.2019, ora 12:00, u zhvillua ankandi me vlerën e re 6.400.000 lekë. Ankandi i ri dështoi për mungesë të ofertave.

Mbledhja e kreditorëve të shoqërisë vendosi që të përsëritet ankandi në datat 1.11.2019, datë 18.12.2019, datë 11.2.2020, datë 30.6.2020, por përsëri dështuan për mungesë ofertash.

Pra, siç rezulton sa më sipër ankandet provuan se vlera tregtare e objektit është më e vogël se 6.400.000 lekë.

Me vendimin e datës 18.12.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur të njohë si shpenzime për shpërblimin e administratorit, për periudhën 18.12.2012 deri në 31.10.2019 në shumën 50,000 lekë në muaj, pa përfshire TVSH-në.

Për periudhën si më sipër janë 84 muaj:

- Shpërblimi i administratorit 50,000 lekë/muaj * 84 muaj = 4,200,000 lekë.



- Tatimi mbi vlerën e shtuar 4,200,000 lekë * 20 % = 840.000 lekë.

- Shpenzime për publikimin në gazetën kombëtare = 30,000 lekë.

- Vlera e përgjithshme = 5,070,000 lekë.

Me vendimin datë 1.11.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur të njohë si shpenzime për periudhën 1.11.2017 deri në datën 31.10.2019 (gjithsej 24 muaj):

- Krenar Sula - Shpenzime për ruajtjen e objektit: 596.000 lekë.

- Veiz Sinomema - Shpenzime për ruajtjen e objektit: 596.000 lekë.

- Agim Alimema - Shpenzime për ruajtjen e objektit: 596.000 lekë.

Shuma e shpenzimeve të procedurës së falimentimit është 6,858,000 lekë.

Pra, siç shihet, në datën 1.11.2019, shuma e shpenzimeve të procedurës tejkalon vlerën e pasurisë së shoqërisë “Luval” sh.p.k., Tepelenë. Në mbledhjen e kreditorëve të datës 1.11.2019, administratori i falimentimit, në mbështetje të nenit 171 të ligjit, njoftoi Gjykatën e Falimentimit se pasuritë nuk mjaftojnë për të përmbushur detyrimet e maturuara, të masës së falimentimit. Gjithashtu, administratori, në mbështetje të nenit 170 të ligjit, njoftoi gjykatën se masa e falimentimit nuk mjafton për mbulimin e shpenzimeve të procedurës dhe i kërkoi gjykatës që të ndërpresë procedurën e falimentimit. Administratori i falimentimit vendosi kalimin e pasurisë së patundshme me nr. 217/1, zona kadastrale 3718, adresa: fshati Vasjar – Bashkia Memaliaj, pronë e shoqërisë “Luval” sh.p.k., Tepelenë, vërtetuar me certifikatën e pronësisë lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Patundshme Tepelenë, në datën 30 prill 2003, në favor të bashkëpronarëve, si më poshtë:

1. Zoti Luan Muça të jetë bashkëpronar në masën 73.9%.

2. Zoti Krenar Sula të jetë bashkëpronar në masën 8.7%.

3. Zoti Veiz Sinomema të jetë bashkëpronar në masën 8.7%.

4. Zoti Agim Alimema të jetë bashkëpronar në masën 8.7%.

Me vendimin nr. 12508, datë 18.12.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur:

- Pranimin e kërkesës së kërkuarit shoqëria “Luval” sh.p.k.

- Hapjen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Luval” sh.p.k., me seli në fshatin Vasjar, Tepelenë.

- Emërimin si administrator të falimentimit për shoqërinë “Luval” sh.p.k. z. Luna Muça.

Në momentin e shqyrtimit të kërkesës objekt gjykimi, Gjykata vëren se janë mbajtur mbledhja për raportimin dhe mbledhja për verifikimin e pretendimeve, të cilat kanë përfunduar me miratimin e tabelave përkatëse të pretendimeve të kreditorëve të shoqërisë “Luval” sh.p.k.

Procedura e falimentimit të kësaj shoqërie është zgjatur prej shumë vitesh për arsye të ndryshme. Gjykata po kryen të gjitha përpjekjet ligjore që kjo procedurë të shkojë drejt përfundimit, duke ftuar administratorin që të studiojë dhe të paraqesë planin e tij për shitjen e masës së falimentimit ose për riorganizimin ekonomik të kësaj shoqërie. Duke qenë se kjo shoqëri ndodhet prej shumë vitesh në këtë procedurë falimentimi, administratori i falimentimit i është drejtuar Gjykatës për të caktuar me vendim përcaktimin e shpërblimit për punën e kryer nga ai gjatë kësaj periudhe që ai është caktuar si administrator i kësaj shoqërie.

Neni 50, i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar) parashikon:

“1. Administratori i falimentimit ka të drejtën e shpërblimit për punën e kryer dhe të rimbursimit për shpenzimet e bëra gjatë përmbushjes së detyrës. 2. Masa e zaksoshme e shpërblimit llogaritet në bazë të vlerës së masës së falimentimit në kohën e përfundimit të procedurës së falimentimit. 3. Masa e zaksoshme e shpërblimit rrvlerësohet në varësi të vëllimit dhe të shkallës së vështirësisë gjatë ushtrimit të detyrës së administratorit të falimentimit.”

Neni 51, i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar) parashikon:

“1. Seksioni tregtar i gjykatës së rrethit përcakton me vendim shpërblimin dhe shpenzimet që duhet t'i rimbursohen administratorit të falimentimit. 2. Vendimi i seksionit tregtar të gjykatës së rrethit, me përjashtim të shumës së parashikuar, duhet të shpallet publikisht, si dhe i njoftohet personalisht administratorit të falimentimit, debitorit dhe anëtarëve të komitetit të kreditorëve, nëse është emëruar prej tyre. Në vendimin e seksionit tregtar të gjykatës së rrethit, të shpallur publikisht, duhet të vihet në dukje se teksti i plotë i këtij vendimi gjendet në sekretarinë e seksionit tregtar të gjykatës së rrethit. 3. Kundër vendimit të seksionit tregtar



të gjykatës së rrethit, administratori i falimentimit, debitori dhe çdo kreditor falimentimi kanë të drejtën e ankimit të veçantë, sipas Kodit të Procedurës Civile.”

Neni 52, i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar), parashikon:

“Rregullat e hollësishme për kushtet dhe kriteret e përcaktimit të masës së shpërblimit dhe të rimbursimit të shpenzimeve të administratorit të falimentimit caktohen nga Këshilli i Ministrave.”

Në bazë dhe për zbatim të dispozitave si lart cituar, me vendimin nr. 197, datë 13.4.2007, të vendimit të Këshillit të Ministrave, “Për kushtet dhe kriteret e përcaktimit të masës së shpërblimit dhe të rimbursimit të shpenzimeve të administratorit të falimentimit”, të Këshillit të Ministrave, është parashikuar se:

“1. Shpërblimi i administratorit të falimentimit përcaktohet nga gjykata, në përputhje me nenet 50 e 51, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”. 2. Në përcaktimin e shpërblimit sipas pikës 1 të këtij vendimi, gjykata merr parasysh punën e kryer, rezultatet e arritura, rëndësinë e falimentimit dhe kujdesin e treguar nga administratori i falimentimit, në përmbushjen e detyrave të tij. 3. Shpërblimi i administratorit të falimentimit përbëhet nga pagimi i një përqindjeje të shumës së aktivitetit të grumbulluar (masa e falimentimit në përfundim të procedurës së falimentimit), sipas këtyre kufijve: a) nga 12 për qind në 14 për qind, kur aktivi nuk është më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë; b) nga 10 për qind në 12 për qind, kur aktivi është mbi 1 000 000 (një milion) deri në 3 000 000 (tre milionë) lekë; c) nga 8.50 për qind në 9.50 për qind, kur aktivi është mbi 3 000 000 (tre milionë) deri në 5 000 000 (pesë milionë) lekë; d) nga 7 për qind në 8 për qind, kur aktivi është mbi 5 000 000 (pesë milionë) deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë; e) nga 5.5 për qind në 6.5 për qind, kur aktivi është mbi 10 000 000 (dhjetë milionë) deri në 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë; dh) nga 4 për qind në 5 për qind, kur aktivi është mbi 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) deri në 100 000 000 (një qind milionë) lekë; e) deri në 1.80 për qind, kur aktivi është mbi 100 000 000 (një qind milionë) deri në 200 000 000 (dyqind milionë) lekë; h) deri në 0.90 për qind, kur tejkalon 200 000 000 (dyqind milionë) lekë. 4. Administratorit të falimentimit i paguhet, gjithashtu, mbi shumën e pasivit të falimentimit, një shpërblim shtesë nga 0,15 deri në 0,75 për qind për shumën deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë dhe nga 0.05 deri në 0.37 për qind për shumën mbi 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë ... 9. Shpërblimi i administratorit përballohet nga

masa e falimentimit. Me vendim të gjykatës, shumën e shpërblimit dhe rimbursimi i shpenzimeve, në përputhje me këtë vendim, mund t'i parapaguhet administratorit të falimentimit ...”

Në nenin 60 të ligjit parashikohet shpërblimi i anëtarëve të komitetit të kreditorëve:

“Anëtarët e komitetit të kreditorëve kanë të drejtën të shpërblehen për punën dhe të rimbursohen për shpenzimet e arsyetuara. Në caktimin e shpërblimit merren parasysh koha dhe vëllimi i punës së anëtarit, si dhe zbatohen kërkesat e neneve 51 dhe 52 të këtij ligji.”

Procedura e falimentimit përfaqëson procesin e likuidimit të një subjekti që ndodhet në kushtet e paaftësisë paguese apo mbingarkesës së tij me borxhe. Kjo procedurë ka për qëllim likuidimin e subjektit, nëse gjykohet se shitja e pasurive të tij, do të jetë me përfitim për kreditorët.

Aktualisht janë përfunduar procedurat e falimentimit, si mbledhja për raportim, verifikimi i pretendimeve të kreditorëve. Gjithashtu është përgatitur raporti fillestar në lidhje me gjendjen e shoqërisë dhe është lënë detyrë nga gjykata që në mbledhjen e ardhshme të kreditorëve të propozohen nga administratori një raport në lidhje me të ardhmen e shoqërisë. Konkretisht administratori do të përgatisë një raport të detajuar për shitjen e masës së falimentimit ose për riorganizimin ekonomik të kësaj shoqërie.

Administratori i falimentimit ka pretenduar shpërblimin e tij, sipas vendimit nr. 197, datë 13.4.2007, “Për kushtet dhe kriteret e përcaktimit të masës së shpërblimit dhe të rimbursimit të shpenzimeve të administratorit të falimentimit”, duke qenë se ai ka pothuajse 5 vjet që është caktuar nga gjykata dhe nuk ka marrë asnjë shpërblim apo duke mos u caktuar asnjë shpërblim për të. Ai ka pretenduar që shpërblimi i tij të jetë në vlerën minimale 50.000 lekë në muaj për periudhën 18.12.2012–24.10.2017. Gjkata konstaton se ndonëse kjo procedurë falimenti ka disa vite që është hapur dhe vazhdon të jetë e tillë nuk ka asnjë vendim të Gjykatës së Falimentimit, për parapagim të administratorit të falimentimit me shpërblim, duke përfutur ndonjë pagesë.

Administratori i falimentimit ka kërkuar nga gjykata edhe shpenzime të tjera, konkretisht:

në lidhje ruajtjen e objektit, në shumën totale 3.531.000 lekë;



shpenzime për pjesëmarrjen në seancat gjyqësore, në shumën 156.000 lekë;

shpenzime karburanti, në shumën 819.000 lekë;

shpenzime për ekspert vlerësues, në shumën 200.000 lekë;

shpenzime për ekspert vlerësues, Violeta Mullai, në shumën 500.000 lekë.

Duke marrë në konsideratë faktin që administrator ka pothuajse 5 vjet që është emëruar dhe nuk është parapaguar për shpenzimet e tij më parë, gjithashtu, edhe faktin që vonesa në këtë procedurë falimenti kanë ardhur për shkaqe të ndryshme që nuk varen nga administratori, Gjykata gjen të bazuar pretendimin e administratorit të falimentimit për miratimin e shpërblimit, duke u vlerësuar në masën minimale, sipas vendimit nr. 197, datë 13.4.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për kushtet dhe kriteret e përcaktimit të masës së shpërblimit dhe të rimbursimit të shpenzimeve të administratorit të falimentimit”, në shumën 50.000 lekë në muaj. Gjithashtu, gjykata pranon edhe kërkesën për pagesën për shpenzime për ekspert vlerësues në shumën 200.000 lekë.

Në bazë të pikës 9, të vendimit nr. 197, datë 13.4.2007, “Për kushtet dhe kriteret e përcaktimit të masës së shpërblimit dhe të rimbursimit të shpenzimeve të administratorit të falimentimit”, të Këshillit të Ministrave, administratori nuk përfiton asnjë shtesë tjetër financiare, pasi ende nuk janë shitur sendet e masës së falimentimit, në realizimin e kredive në favor të rritjes së masës së falimentimit.

Ndërsa, në lidhje me shpenzimet për ruajtjen e objektit, në shumën totale 3.531.000 lekë, shpenzime për pjesëmarrjen në seancat gjyqësore, në shumën 156.000 lekë, shpenzime karburanti në shumën 819.000 lekë, shpenzime për ekspert vlerësues, Violeta Mullai, në shumën 500.000 lekë, gjykata çmon se administratori nuk i ka shoqëruar këto pretendime me aktet shkresore juridike dhe financiare që duhet të shoqërojnë këto shpenzime të pretenduara. Administratori nuk ka paraqitur asnjë kontratë pune për ruajtjen e objekteve, gjithashtu, dhe asnjë faturë tatimore shitjeje për të gjitha shërbimet dhe aktivitetin që ai kërkon t'i paguhen këto shpenzime.

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës, pas analizës së faktit dhe të parashikimeve në ligj, Gjykata vëren se kërkesa është pjesërisht e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë ajo duhet të pranohet.

Me anë të vendimit datë 18.12.2017, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës së administratorit të falimentimit të shoqërisë “Luval” sh.p.k.

2. Pagimin e shpërblimit për administratorin e falimentimit të shoqërisë “Luval” sh.p.k. në falimentim, Luan Muça, në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë në muaj për punën e kryer nga data 18.12.2012 deri më datë 24.10.2017, përfshirë TVSH-në.

3. Pagimin e shpërblimit për pagesën për shpenzime për ekspert vlerësues gjatë procedurës së falimentimit në shumën 200.000 lekë përfshirë TVSH-së.

4. Rrëzimin e për pjesën tjetër të kërkesës për shpenzime.

Procedura e falimentimit përfaqëson procesin e likuidimit të një subjekti që ndodhet në kushtet e paaftësisë paguese apo të mbingarkesës së tij me borxhe. Kjo procedure ka për qëllim likuidimin e subjektit, nëse gjykohet se shitja e pasurive të tij, do të jetë me përfitim për kreditorët.

Aktualisht, janë përfunduar procedurat e falimentimit, si: mbledhja për raportim, verifikimi i pretendimeve të kreditorëve. Gjithashtu është përgatitur raporti fillestar, në lidhje me gjendjen e shoqërisë dhe është lënë detyrë nga gjykata që në mbledhjen e ardhshme të kreditorëve të propozohen nga administratori një raport në lidhje me të ardhmen e shoqërisë. Konkretisht, administratori do të përgatisë një raport të detajuar për shitjen e masës së falimentimit ose për riorganizimin ekonomik të kësaj shoqërie.

Administratori i falimentimit ka pretenduar shpërblimin e tij, sipas vendimit nr. 197, datë 13.4.2007, “Për kushtet dhe kriteret e përcaktimit të masës së shpërblimit dhe të rimbursimit të shpenzimeve të administratorit të falimentimit”, duke qenë se ai ka pothuajse 5 vjet që është caktuar nga gjykata dhe nuk ka marrë asnjë shpërblim apo duke mos u caktuar asnjë shpërblim për të. Ai ka pretenduar që shpërblimi



i tij të jetë në vlerën minimale 50.000 lekë në muaj për periudhën 1.11.2017–31.10.2019. Gjykata konstaton se ndonëse kjo procedurë falimenti ka disa vite që është hapur dhe vazhdon të jetë e tillë nuk ka asnjë vendim të Gjykatës së Falimentimit, për parapagim të Administratorit të Falimentimit me shpërblim, duke përfutur ndonjë pagesë.

Duke marrë në konsideratë faktin që administratori ka pothuajse 5 vjet që është emëruar dhe nuk është parapaguar për shpenzimet e tij më parë, gjithashtu, edhe faktin që vonesa në këtë procedurë falimenti kanë ardhur për shkaqe të ndryshme që nuk varen nga administratori, Gjykata gjen të bazuar pretendimin e administratorit të falimentimit për miratimin e shpërblimit, duke u vlerësuar në masën minimale, sipas vendimit nr. 197, datë 13.4.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për kushtet dhe kriteret e përcaktimit të masës së shpërblimit dhe të rimbursimit të shpenzimeve të administratorit të falimentimit”, në shumën 50.000 lekë në muaj. Gjithashtu, gjykata pranon edhe kërkesën për pagesën për shpenzime për ekspert vlerësues në shumën 200.000 lekë.

Në bazë të pikës 9, të vendimit nr. 197, datë 13.4.2007, “Për kushtet dhe kriteret e përcaktimit të masës së shpërblimit dhe të rimbursimit të shpenzimeve të administratorit të falimentimit”, të Këshillit të Ministrave, administratori nuk përfiton asnjë shtesë tjetër financiare, pasi ende nuk janë shitur sendet e masës së falimentimit, në realizimin e kredive në favor të rritjes së masës së falimentimit.

Administratori i falimentimit ka kërkuar nga gjykata edhe shpenzime të tjera në lidhje ruajtjen e objektit në shumën totale 1.788.000 lekë. Nga kontrata e punës datë 1.11.2017, e lidhur me administratorin e falimentimit të shoqërisë “Luval” sh.p.k. në falimentim, Luan Muça me shtetasin Agim Alimema, rezulton se shtetasi Agim Alimema ka marrë përsipër ruajtjen fizike të objektit me pagë bruto 24.000 lekë në muaj, për një afat të pacaktuar, sipas të drejtave dhe detyrimeve në kontratën e punës.

Nga kontrata e punës datë 1.11.2017, e lidhur me administratorin e falimentimit të shoqërisë “Luval” sh.p.k. në falimentim, Luan Muça me shtetasin Veiz Sinomema, rezulton se shtetasi Veiz Sinomema ka marrë përsipër ruajtjen fizike

të objektit me pagë bruto 24.000 lekë në muaj, për një afat të pacaktuar sipas të drejtave dhe detyrimeve në kontratën e punës.

Nga kontrata e punës datë 1.11.2017 e lidhur me administratorin e falimentimit të shoqërisë “Luval” sh.p.k. në falimentim, Luan Muça me shtetasin Krenar Sula, rezulton se shtetasi Krenar Sula ka marrë përsipër ruajtjen fizike të objektit me pagë bruto 24.000 lekë në muaj, për një afat të pacaktuar, sipas të drejtave dhe detyrimeve në kontratën e punës.

Nga kontrata e punës datë 1.11.2017, e lidhur me administratorin e falimentimit të shoqërisë “Luval” sh.p.k. në falimentim, Luan Muça me shtetasin Krenar Sula, rezulton se shtetasi Krenar Sula ka marrë përsipër ruajtjen fizike të objektit me pagë bruto 24.000 lekë në muaj, për një afat të pacaktuar, sipas të drejtave dhe detyrimeve në kontratën e punës.

Administratori i falimentimit të shoqërisë “Luval” sh.p.k. në falimentim, Luan Muça, ka paraqitur grafikun e shërbimit për ndarjen dhe kryerjen e grafikut të shërbimit për të tre punonjësit, sipas kontratave të mësipërme të punës.

Me anë të vendimit datë 1.11.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur:

Pagimin e shpërblimit për administratorin e falimentimit të shoqërisë “Luval” sh.p.k. në falimentim, Luan Muça, në shumën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë në muaj për punën e kryer nga data 1.11.2017 deri më datë 31.10.2019 përfshirë TVSH-në në shumën totale 1.770.000 (një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë.

Njohjen e shpenzimeve të kryera nga administratori i falimentimit të shoqërisë “Luval” sh.p.k. në falimentim, Luan Muça, për shërbimin e ruajtjes fizike të objektit “Fabrika e Tullave”, Vasjar, Memaliaj, në shumën 1.788.000 (një milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë.

Në datën 15 korrik 2019, u zhvillua ankandë për shitjen e pasurisë së shoqërisë, shoqërisë “Luval sh.p.k. nr. 217/1, zona kadastrale 3718, me adresë Vasjar, Tepelenë. Vlera fillestare e ankandit ishte 6,400,000 lekë. Në ankand nuk u shpreh asnjë i interesuar për blerjen e pasurisë si më sipër. Ndërkohë, me vendimin e datës 18.12.2017, si dhe të datës 1.11.2019, gjykata njohu si shpenzime për shpërblimin e



administratorit për periudhën 18.12.2012 deri në 31.10.2019 në shumën 50,000 lekë në muaj pa përfshirë TVSH-në.

Për periudhën si më sipër janë 84 muaj:

- Shpërblimi i administratorit: 50,000 lekë/muaj * 84 muaj = 4,200,000 lekë.

- Tatimi mbi vlerën e shtuar: 4,200,000 lekë * 20% = 840.000 lekë.

- Shpenzime për publikimin në gazetë kombëtare = 30,000 lekë.

- Vlera e përgjithshme = 5,070,000 lekë.

Me vendimin e datës 1.11.2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor ka njohur si shpenzime për periudhën 1.11.2017 deri në datën 31.10.2019 (gjithsej 24 muaj).

- Krenar Sula - Shpenzime për ruajtjen e objektit: 596.000 lekë.

- Veiz Sinomema - Shpenzime për ruajtjen e objektit: 596.000 lekë.

- Agim Alimema - Shpenzime për ruajtjen e objektit: 596.000 lekë.

Shuma e shpenzimeve totale të procedurës së falimentimit është 6,858,000 lekë.

Pra, siç shihet ka pasuri të pamjaftueshme për shlyerjen e shpenzimeve të procedurës. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 171, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentin”, ju njoftojmë se mbulohen shpenzimet e procedurës së falimentimit, por pasuritë nuk mjaftojnë për të përmbushur detyrime të tjera, të maturuara, të masës së falimentimit.

Me vendimin e administratorit të falimentimit të datës 18.12.2019 është vendosur që pasuria e shoqërisë të shpërndahet për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit. Në mbështetje të nenit 174, pika 1, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentin”, administratori ka kërkuar para gjykatës ndërprerjen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Luval” sh.p.k., Tepelenë.

Administratori i falimentimit, pasi mori në shqyrtim shpenzimet e procedurës së falimentimit të njohura nga gjykata, si dhe pasuritë në dispozicion të shoqërisë, ka konstatuar se:

Shpenzimet e procedurës së falimentimit janë në total, në shumën 6,858,000 lekë. Nga këto si më poshtë:

Shpenzime për administratorin e shoqërisë Luan Muça 5,070,000 lekë ose 73.9%.

Shpenzime për Krenar Sula

596,000 lekë ose 8.7%.

Shpenzime për Veiz Sinomema

596,000 lekë ose 8.7%.

Shpenzime për Agim Alimema

596,000 lekë ose 8.7%.

Pasuritë e shoqërisë, pasuri e paluajtshme nr. 217/1, zona kadastrale 3718, ndodhur fshati Vasjar, Tepelenë, ka vlerën 6,400,000 lekë.

Në mbështetje të nenit 172, pika 1, germa “a” dhe të nenit 174, 171 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, administratori i shoqërisë në falimentim “Luval” sh.p.k. i ka propozuar gjykatës, që të:

Të shpërndajë pasurinë e paluajtshme nr. 217/1, zona kadastrale 3718, adresa: fshati Vasjar, Tepelenë, në bashkëpronësi, si më poshtë:

1. Luan Muça të jetë bashkëpronar, në masën 73.9%.

2. Krenar Sula të jetë bashkëpronar, në masën 8.7%.

3. Veiz Sinomema të jetë bashkëpronar, në masën 8.7%.

4. Agim Alimema të jetë bashkëpronar, në masën 8.7%.

Ndërprerja për mungesë të pasurive në masën e falimentimit, në qoftë se pas fillimit të procedurës së falimentimit rezulton se masa e falimentimit nuk mjafton për mbulimin e shpenzimeve të procedurës, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit e ndërpret procedurën. Ndërprerja nuk bëhet kur parapaguhet një shumë e mjaftueshme.

Nga certifikata për vërtetim pronësie, datë 30.4.2003, lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Tepelenë (ish-zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tepelenë) rezulton se në emër të shoqërisë tregtare “Luval” sh.p.k. është regjistruar pasuria nr. 217/1, vol. 6, f. 20, zona kadastrale 3718, 5089 metra katrorë ndërtesë dhe 25000 metra katrorë truall me qira. Pra, kjo shoqëri ka në pronësi vetëm ndërtesën, ndërsa trualli është në pronësi shtet, por është përdorur me qira nga kjo shoqëri tregtare.

Administratori përdor çdo shumë në të holla, që gjendet në masën e falimentimit, për shlyerjen e shpenzimeve të procedurës: së pari paguhet shpenzimet në përpjesëtim me shumën përkatëse para ndërprerjes së procedurës. Administratori



nuk mban përgjegjësi të mëtejshme për disponimin e sendeve të masës së falimentimit.

Nëse mbulohen shpenzimet e procedurës së falimentimit, por pasuritë nuk mjaftojnë për të përmbushur detyrime të tjera, të maturuara, të masës së falimentimit, administratori i falimentimit njofton seksionin tregtar të gjykatës së rrethit për pamjaftueshmërinë e pasurive. E njëjta gjë vlen kur pasuritë parashikohen të jenë të pamjaftueshme për plotësimin e detyrimeve të tjera ekzistuese të masës së falimentimit në datën e maturimit.

Gjykata shpall publikisht njoftimin për pamjaftueshmëri të pasurive në masën e falimentimit.

Njoftimi u bëhet individualisht kreditorëve të masës së falimentimit. Detyra e administratorit, për administrimin dhe për përdorimin e pasurive të masës së falimentimit, vazhdon edhe pas njoftimit për pamjaftueshmërinë e pasurive.

Seksioni tregtar i Gjykatës së Rrethit ndërpret procedurën e falimentimit, pasi administratori i falimentimit ta këtë shpërndarë masën e falimentimit, sipas nenit 172 të këtij ligji. Administratori

paraqet llogari të veçanta për veprimtarinë e vet pas njoftimit për pamjaftueshmërinë e pasurive në masën e falimentimit.

Por, në çdo rast, në qoftë se pas ndërprerjes së procedurës gjenden sende që formojnë pjesë të masës së falimentimit, seksioni tregtar i Gjykatës së Rrethit, me kërkesë të administratorit ose të një kreditori të masës, urdhëron shpërndarje të vonuar. Nenet 166, pika 3, 167 dhe 168, të këtij ligji zbatohen sipas rastit. Pra, ky proces mund të rihapet nëse do të gjenden pasuri të tjera.

Në këtë kërkesë për ndërprerje të procedurës, administratori ka propozuar miratimin e vendimit të administratorit të falimentimit, datë 18.12.2019, mbi shpërndarjen e pasurisë së shoqërisë, pasuri e paluajtshme nr. 217/1, zona kadastrale 3718, regjistruar sipas certifikatës për vërtetim pronësie, datë 30.4.2003, lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Tepelenë (ish-Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tepelenë) pasuria nr. 217/1, vol. 6, f. 20, zona kadastrale 3718, 5089 metra katrorë ndërtesë dhe 25.000 metra katrorë truall me qira, ndodhur në Vasjar, Tepelenë, mbështetur në nenin 172, pika

1, germa “a”, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002.

Gjithashtu është kërkuar të ngarkohet administratori i falimentimit të shoqërisë të bëjë para noterit publik, kontratën e kalimit të pronësisë për pasurinë e paluajtshme nr. 217/1, zona kadastrale 3718, pronë e shoqërisë “Luval” sh.p.k., Tepelenë, regjistruar sipas certifikatës për vërtetim pronësie, datë 30.4.2003, lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Tepelenë (ish-Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tepelenë), pasuria nr. 217/1, vol. 6, f. 20, zona kadastrale 3718, 5089 metra katrorë ndërtesë dhe 25.000 metra katrorë truall me qira, ndodhur në Vasjar, Tepelenë, në favor të bashkëpronarëve, si më poshtë:

- Luan Myftar Muçam mbajtës i kartës së identitetit me numër G10918009M, bashkëpronar në masën 73.9% të pasurisë së patundshme nr. 217/1, zona kadastrale 3718.

- Agim Sefedin Alimema, mbajtës i kartës së identitetit me numër G00110253E, bashkëpronar në masën 8.7% të pasurisë së patundshme nr. 217/1, zona kadastrale 3718.

- Krenar Arif Sula, mbajtës i kartës së identitetit me numër G20225179N, bashkëpronar në masën 8.7% të pasurisë së patundshme nr. 217/1, zona kadastrale 3718.

- Veiz Hazis Sinomema, mbajtës i kartës së identitetit me numër F20327069M, bashkëpronar në masën 8.7% të pasurisë së patundshme nr. 217/1, zona kadastrale 3718.

Sipas përllogaritjeve të administratorit Luan Muça, vlera e pronës është 6.400.000 lekë, është shlyer plotësisht nga bashkëpronarët si më sipër me shpenzimet e procedurës së falimentimit.

Kërkesa për ndërprerjen e procedurës së falimentimit, sipas neneve 175 ose 176 të këtij ligji,

duhet të shpallet publikisht. Ajo depozitohet në regjistrin e gjykatës për inspektim të palëve. Në rastin e parashikuar në nenin 179, kërkesa shoqërohet edhe nga deklarata e miratimit të kreditorëve. Brenda një jave pas shpalljes publike, kreditorët e falimentimit kanë mundësinë ta kundërshtojnë me shkrim këtë kërkesë ose të regjistrojnë kundërshtimin në protokollin e regjistrimit

të gjykatës. Administratori Luan Muça e ka marrë këtë vendim më datë 18.12.2019 dhe e ka



depozituar në gjykatë. Gjatë kësaj periudhë gjykata ka njoftuar të gjitha subjektet e interesuara për këtë procedurë falimentimi, debitorët dhe kreditorët me mjetet sipas ligjit. Gjithashtu, gjykata i ka lënë detyrë administratorit që gjatë kësaj periudhe ta njoftojë disa herë këtë vendim për ndërprerje të procedurës së falimentimit.

Para se të vendosë për ndërprerjen e procedurës së falimentimit, kjo gjykatë ka dëgjuar disa herë palët: administratorin e falimentimit, kreditorët e interesuar dhe debitorët. Gjikata iu ka lënë një kohë shumë të gjatë subjekteve të interesuara që të njihen me këtë vendim dhe të paraqesin mendimet e tyre në lidhje me këtë procedurë.

Duke qenë sa më sipër, asnjë nga kreditorët apo debitorët nuk kanë kundërshtuar apo reklamuar veprimet dhe kërkesën e paraqitur nga administratori i falimentimit të Shoqërisë “Luval” sh.p.k. në falimentim, Luan Muça, gjykata ka krijuar bindjen se kjo kërkesë është e mbështetur në ligj.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, bazuar në nenet 126, 306–308 të Kodit të Procedurës Civile, nenet 3, 4, 5, 6, 172, 174 e në vijim të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar),

VENDOSI:

Pranimin e kërkesës së administratorit të falimentimit të shoqërisë “Luval” sh.p.k.

Ndërprerjen e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Luval” sh.p.k., Tepelenë, me adresë: fshati Vasjar, Tepelenë, mbështetur në nenin 174, pika 1, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin” (i ndryshuar).

Miratimin e vendimit të administratorit të falimentimit datë 18.12.2019, mbi shpërndarjen e pasurisë së shoqërisë, pasuri e paluajtshme nr. 217/1, zona kadastrale 3718, regjistruar sipas certifikatës për vërtetim pronësie datë 30.4.2003, lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Tepelenë (ish-Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tepelenë), pasuria nr. 217/1, vol. 6, f. 20, zona kadastrale 3718, 5089 metra katrorë ndërtesë dhe 25.000 metra katrorë truall me qira,

ndodhur në Vasjar, Tepelenë, mbështetur në nenin 172, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002.

Ngarkohet administratori i falimentimit të shoqërisë Luan Muça të bëjë para noterit publik kontratën e kalimit të pronësisë për pasurinë e paluajtshme nr. 217/1, zona kadastrale 3718, pronë e shoqërisë “Luval” sh.p.k., Tepelenë, regjistruar sipas certifikatës për vërtetim pronësie datë 30.4.2003 lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Tepelenë (ish-Zyra e Regjistrimit të Pasurive të paluajtshme Tepelenë) pasuria nr. 217/1, vol. 6, f. 20, zona kadastrale 3718, 5089 metra katrorë ndërtesë dhe 25.000 metra katrorë truall me qira, ndodhur në Vasjar, Tepelenë, në favor të bashkëpronarëve si më poshtë:

- Luan Myftar Muça - bashkëpronar në masën 73.9% të pasurisë së patundshme nr. 217/1, zona kadastrale 3718.

- Agim Sefedin Alimema - bashkëpronar në masën 8.7% të pasurisë së patundshme nr. 217/1, zona kadastrale 3718.

- Krenar Arif Sula - bashkëpronar në masën 8.7% të pasurisë së patundshme nr. 217/1, zona kadastrale 3718.

- Veiz Hazis Sinomema - bashkëpronar në masën 8.7% të pasurisë së patundshme nr. 217/1, zona kadastrale 3718.

Sipas përlllogaritjeve të administratorit Luan Muça, vlera e pronës është 6.400.000 lekë, është shlyer plotësisht nga bashkëpronarët si më sipër me shpenzimet e procedurës së falimentimit.

Urdhërohet çregjistrimi i shoqërisë “Luval” sh.p.k., Tepelenë, me NIPT K09011506A nga Regjistri Tregtar i Shoqërive Tregtare pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Urdhërohet çregjistrimi i shoqërisë “Luval” sh.p.k., Tepelenë, me NIPT K09011506A nga organet tatimore, si dhe të gjitha institucionet e tjera shtetërore.

Urdhërohet publikimi i vendimit për mbylljen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Luval” sh.p.k., Tepelenë në Buletinin Zyrtar të Njoftimeve Publike.

Urdhërohet publikimi i vendimit për mbylljen e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Luval” sh.p.k. Tepelenë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Urdhërohet publikimi i vendimit për mbylljen e procedurave të falimentimit të shoqërisë



“Luval” sh.p.k. Tepelenë në adresën zyrtare në internet të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet nga Administratori i Falimentimit të Shoqërisë Luval sh.p.k. dhe kreditorëve të kësaj shoqërie.

Një kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Një kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë.

Një kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë.

Një kopje e këtij vendimi të shpallet publikisht në faqen zyrtare të internetit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Teksti i plotë i këtij vendimi gjendet në Sekretarinë e Seksionit Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Shpenzimet gjyqësore sipas ligjit për falimentimin.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e nesërme e shpalljes publike/njoftimit të këtij vendimi.

U shpall në Tiranë, sot, më datë 2.10.2020.

SEKRETARE
Klaudia Abazaj

GJYQTAR
Julian Haxhiu

Shpenzime gjyqësore	Pala që ka parapaguar/paguar shpenzimin gjyqësor				Sasia	Çmimi	Vlera
	Gjykata	Paditës	I paditur	P. e tretë			
Shpenzime për njoftime pranë gj. Julian Haxhiu	2250				15	150	2250
Shpenzime për njoftime pranë gj. Manjola Bejleri	2400				16	150	2400
SHUMA	4650	0	0	0			4650 lekë

KËRKESË

Nr. 6547, datë 19.10.2020

PËR SHPREHJE INTERESI TË KANDIDATËVE TË INTERESUAR PËR T’U ZGJEDHUR ANËTARË TË BORDIT DISIPLINOR TË DHOMËS KOMBËTARE TË NOTERISË

Në zbatim të nenit 42, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, dhe të urdhrit të ministrit të Drejtësisë me nr. 169, datë 10.6.2020, “Për miratimin e rregullave të hollësishme për paraqitjen dhe për trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore për anëtarë të bordit disiplinor”, Ministria e Drejtësisë shpall kërkesën për shprehje interesi të kandidatëve të interesuar për t’u zgjedhur anëtarë të Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë, për 2 anëtarët të cilët zgjidhen nga ministri i Drejtësisë.

1. Kandidatët e interesuar, për të qenë anëtarë të Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë, duhet të plotësojnë kushtet ligjore të

parashikuara në pikën 2, të nenit 42, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”, ku parashikohet se:

“2. Kandidatët e zgjedhur, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) të jenë shtetas shqiptarë;
- b) të kenë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi ose diplomë të njësuar me të;
- c) të kenë jo më pak se 15 vjet përvojë profesionale si jurist;
- ç) të mos jenë shkarkuar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- d) të mos kenë qenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
- dh) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit, në kuptimin e legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë;
- e) në kohën e kandidimit, të mos kenë asnjë anëtar të familjes, si dhe të afërm të shkallës së parë që është noter në detyrë.”

2. Në përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit Disiplinor preferencë do të kenë kandidatët që zotërojnë titull ose gradë shkencore ose kanë



eksperiencë të provuar shkencore dhe/ose profesionale në çështjet e së drejtës civile.

3. Kandidatët e interesuar duhet të depozitojnë me postë, dorazi në protokollin e Ministrisë së Drejtësisë apo në rrugë elektronike pranë Ministrisë së Drejtësisë, dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) kërkesë për shprehje interesi;
- b) jetëshkrim;
- c) kopje të mjetit të identifikimit;
- ç) diplomë që vërteton përfundimin e ciklit të dytë të studimeve universitare për drejtësi ose diplomë të njësuar me të;

d) vërtetim nga punëdhënësi aktual apo ai i mëparshëm, ku të përcaktohet vjetërsia në punë dhe fakti nëse ka apo jo masa disiplinore, shoqëruar me kopje të librezës së punës;

dh) autorizim për verifikimin e gjendjes gjyqësore;

e) deklaratë se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit, në kuptimin e legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe autorizimin përkatës për kryerjen e verifikimeve;

ë) deklaratë se nuk ka asnjë anëtar të familjes, si dhe të afërm të shkallës së parë që është noter në detyrë;

f) çdo dokument tjetër provues që vërteton plotësimin e kriterëve ligjore.

4. Afati për dorëzimin e dokumentacionit pranë Ministrisë së Drejtësisë është deri në datën 2.11.2020.

5. Kandidatët e interesuar për të qenë anëtarë të Bordit Disiplinor të Noterisë nuk duhet të jenë anëtarë të Bordit të Auditimit, si dhe të organeve të tjera drejtuese të Dhomës Kombëtare të Noterisë.

6. Për secilin kandidat që ka përcjellë shprehje interesi përgatitet relacion, me të cilin kandidati ka të drejtë të njihet në përfundim të procedurës administrative. Pas procesit të vlerësimit, secilit kandidat i njoftohet vendimmarrja, së bashku me relacionin e përgatitur për kandidatin.

7. Kandidatët e interesuar kanë të drejtën e ankimit, brenda 3 ditëve nga dita e njoftimit, sipas pikës 11 të këtij urdhri.

8. Lista përfundimtare e renditjes së kandidatëve publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

9. Vendimi për kandidatin fitues, formalizohet me aktin përkatës administrativ të ministrit të Drejtësisë dhe publikohet në faqen zyrtare të institucionit përkatës dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe u komunikohet njëkohësisht kandidatëve fitues dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë.

10. Nëse kandidati fitues, sipas renditjes përfundimtare, tërhiqet, përzgjidhet kandidati i renditur menjëherë pas tij në listë.

**PËR SHPREHJE INTERESI TË
KANDIDATËVE TË INTERESUAR PËR
T’U ZGJEDHUR ANËTAR I
KOMISIONIT DISIPLINOR TË
PËRMBARUESVE GJYQËSORË
PRIVATË**

Në zbatim të nenit 73, të ligjit nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, dhe të urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. 197, datë 26.6.2020, “Për miratimin e rregullave për paraqitjen, trajtimin e shprehjeve të interesit, si dhe verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore, për anëtarët e Komisionit Disiplinor të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë”, Ministria e Drejtësisë shpall kërkesën për shprehje të interesi të kandidatëve të interesuar për t’u zgjedhur anëtarë të Komisionit Disiplinor të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, për një anëtar i cili zgjidhet nga ministri i Drejtësisë.

1. Kandidatët e interesuar për të qenë anëtarë të Komisionit Disiplinor të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë duhet të plotësojnë kushtet ligjore të parashikuara në pikën 2, të nenit 73, të ligjit nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat”, ku parashikohet se:

“2. Kandidatët e zgjedhur sipas pikës 1, shkronjat “a” dhe “b”, të këtij neni, duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) të jenë shtetas shqiptarë;*
- b) të kenë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi ose diplomë të njësuar me të;*
- c) të kenë jo më pak se 10 vjet përvojë profesionale si jurist;*
- ç) të mos jenë shkarkuar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe të mos kenë masë disiplinore në fuqi;*



d) të mos kenë qenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;

dh) të mos kenë qenë anëtarë, bashkëpunëtorë ose të favorizuar të ish-Sigurimit të Shtetit, në kuptimin e legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë;

e) në kohën e kandidimit, të mos kenë asnjë anëtar të familjes, si dhe të afërm të shkallës së parë që është përmbarues gjyqësor në detyrë.”

2. Në përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Disiplinor kanë përparësi kandidatët që zotërojnë titull ose gradë shkencore ose kanë eksperiencë të provuar shkencore dhe/ose profesionale në çështjet e së drejtës civile.

3. Kandidatët e interesuar për të qenë anëtarë të Komisionit Disiplinor të Përmbaruesve Gjyqësor Privatë të zgjedhur nga Ministria e Drejtësisë, duhet të depozitojnë me postë, dorazi në protokollin e Ministrisë së Drejtësisë apo në rrugë elektronike pranë Ministrisë së Drejtësisë, dokumentacionin e mëposhtëm, vërtetues të plotësimit të kushteve ligjore:

a) kërkesë për shprehje interesi;

b) jetëshkrim;

c) kopje të mjetit të identifikimit;

ç) diplomën që vërteton përfundimin e ciklit të dytë të studimeve universitare për drejtësi ose diplomë të njësuar me të;

d) vërtetimi nga punëdhënësi aktual apo ai i mëparshëm, ku të përcaktohet vjetërsia në punë dhe fakti nëse ka apo jo masa disiplinore, shoqëruar me kopje të librezës së punës;

dh) autorizim për verifikimin e gjendjes gjyqësore;

e) deklaratë se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit, në kuptimin e legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe autorizimin përkatës për kryerjen e verifikimeve;

ë) deklaratë se nuk ka asnjë anëtar të familjes, si dhe të afërm të shkallës së parë që është përmbarues në detyrë;

f) çdo dokument tjetër provues që vërteton plotësimin e kriterëve ligjore.

4. Afati për dorëzimin e dokumentacionit pranë Ministrisë së Drejtësisë është deri në datën 2.11.2020.

5. Për secilin kandidat që ka përcjellë shprehje interesi përgatitet relacion, me të cilin kandidati ka të drejtë të njihet në përfundim të procedurës administrative. Pas përfundimit të procesit të verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore, secilin kandidat i njoftohet vendimi për plotësimin ose jo të kushteve ligjore.

6. Kandidatët e interesuar kanë të drejtën e ankimit, brenda 3 ditëve nga dita e njoftimit.

7. Lista përfundimtare e renditjes së kandidatëve publikohet përkatësisht në faqen zyrtare të institucioneve.

8. Vendimi për kandidatin fitues formalizohet me aktin përkatës administrativ të ministrit të Drejtësisë dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

9. Nëse kandidati fitues, sipas renditjes përfundimtare, tërhiqet, përzgjidhet kandidati i renditur menjëherë pas tij në listë.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

Tiranë, 2020